



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ARKIVI QENDROR SHTETËROR I DREJTËSISË

UDHËZIM PËR APLIKIMIN NË PLATFORMËN E-ALBANIA

Në mbështetje të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat", i ndryshuar, normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, Ligjit nr 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, VKM-së nr. 250, datë 30.04.2025, "Për organizimin dhe funksionimin e Arkivit Qendror Shtetëror të Drejtësisë", si dhe në përputhje me VKM-në nr. 252, datë 29.04.2022, "Për procedurat e ofrimit të Shërbimeve ON-LINE nga institucionet shërbim-ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre", shërbimi i dërgimit dhe/apo të studimit të çfarëdo dokumenti arkivor gjyqësor kryhet vetëm nëpërmjet platformës e-albania.

ASNJË KËRKESË NUK PRANOHEK ME POSTË APO PERSONALISHT PRANË NESH.

Hapni linkun www.e-albania.al, përdorni butonin Hyr, më pas zgjidhni opsionin si qytetar, vendosni numrin personal të ID-së dhe fjalëkalimin për të aksesuar profilin tuaj.

Klikoni tek Shërbime me titullin "Aplikim online për dokumente gjyqësore nga Arkivi Qendror Shtetëror i Drejtësisë".

• **Klikoni opsionin Përdor**

Zgjidhni llojin e aplikimit: Zgjidh opsionin- Njohje pronësie/trashëgimie, Birësim, Njohje atësie, Penale

Lidhja e kërkesës me paditësin: Zgjidh opsionin- Vetë personi, I ati/e ëma, gjyshe, katragjyshe, trashëgimtar tjetër;

Të dhënat e dosjes gjyqësore-Plotësoni vendet bosh:

Numri i vendimit _____, Data, muaji, viti _____ Gjykata _____

KUJDES: Nëse nuk keni lidhje të qartë me dokumentin gjyqësor që kërkon, **DUHET** të bashkëlidhni dokumentin që vërteton lidhjen ligjore.

Si trashëgimtar- *Certifikatë trangu familjar dhe Certifikatë vdekje e parardhësit; ose*

Si përfaqësues ligjor- *Prokurë të Posaçme; ose*

Në rast të fitimit të pronësisë me blerje- *Kontratë shit-blerje me subjektin palë në procesin gjyqësor, dokumentacionin e të cilit kërkon të aksesoni; ose*

Në rast regjistrimi prone të paluajtshme- *Shkresën nga ASHK vendore që përcakton nevojën e aksesit të një dosje gjyqësore*

• **Klikoni opsionin Dërgo,**

Pas marrjes së kërkesës online, pas verifikimit përkatës për dokumentin dhe lidhjen ligjore në platformën e-albania ju ngarkohet fatura e pagesës.

Subjekti kërkuar shkarkon faturën dhe kryen pagesën në çdo degë banke (*tarifa e shërbimit është 1500 lekë plus 200 lekë për çdo akt nga dosja gjyqësore nëse i takon dhe ekziston pranë nesh*)

Pasi kërkuar ngarkon konfirmimin bankar për kryerjen e pagesës në aplikimin e kryer, AQSHD i vë në dispozicion kërkuar dokumentin arkivor gjyqësor të kërkuar në format digjital më vulë elektronik brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune.

NËSE nga verifikimi i kryer: a) dokumenti arkivor gjyqësor i kërkuar **NUK** gjendet; apo b) dokumenti që vërteton lidhjen ligjore me të **NUK** bashkëlidhet në aplikim, AQSHD saktëson në shkresën e ngarkuar në aplikim arsyen e mosngarkimit të aktit/dokumentit gjyqësor të kërkuar si dhe adreson subjektin ku ta kërkojë dokumentin.

NËSE konfirmimi bankar për kryerjen e pagesës **NUK** bashkëlidhet në aplikim, AQSHD REFUZON OFRIMIN E SHËRBIMIT duke saktësuar në shkresën e ngarkuar në aplikim arsyen.

Titullari Institucionit

